

PËRFSHRIJA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT RREGULLATIV GJATË HARTIMIT LIGJOR



Maj 2016

1. Hyrje

Zbatimi i Vlerësimit të Ndikimit Rregullativ (VNR) në Republikën e Kosovës për projektligjet dhe plotësim-ndryshimet e ligjeve është paraparë fillimisht me Rregulloren nr.01/2007 për Punën e Qeverisë¹. Kjo rregullore më vonë është shfuqizuar dhe zëvendësuar me Rregulloren nr.09/2011 e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës², e cila nuk ka paraparë zbatimin e VNR me rastin e hartimit të projekt-akteve ligjore. Për shkak të mungesës së ekspertizës, kapaciteteve të kufixuara buxhetore dhe aprovimit të ligjeve në procedurë të përshpejtuar, VNR nuk ishte zbatuar asnjëherë në praktikë.

Në maj 2014, Qeveria ka miratuar Strategjinë për Rregullim më të Mirë 2014-2020 - Vlerësimi i Ndikimit Rregullativ³. Kjo strategji ka rrejdhe si kërkesë e realizimit të qëllimeve të përcaktuara në Strategjinë e Zhvillimit të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme në Kosovë 2012-2016 me vision 2020⁴, e cila ka paraparë vurjen në funksion të VNR-së me qëllim të përmirësimit të infrastrukturës ligjore të të bërit biznes, si dhe Strategjinë për Bashkëpunim me Shoqëri Civile 2013-2017⁵, e cila ka paraparë përcaktimin e standardeve të përfshirjes së organizatave të shoqërisë civile në hartimin dhe zbatimin e legjislacionit.

Në funksion të përmirësimit të zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm në Kosovë, në janar 2016 Qeveria ka miratuar Strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2016-2021⁶. Edhe në këtë strategji është paraparë miratimi i politikave të bazuara në të dhëna. Ky qëllim është vënë si nevojë e adresimit të problemit që ligjet dhe aktet nënligjore në Kosovë miratohen duke mos aplikuar VNR-në dhe duke mos u konsultuar mirë me komunitetin e biznesit dhe palët tjera të interesit të cilat ndikohen nga ato akte

¹ Rregullore Nr. 01/2007 për Punën e Qeverisë. Neni 4, qasur më 03.02.2016, shih: <http://bit.ly/1Rkp1BF>


² Rregullore Nr.09/2011 e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, qasur më 15.01.2016, shih: <http://bit.ly/1UFcGup>

³ Vendimi për miratimin e Strategjisë për Rregullim më të Mirë 2014-2016, Vlerësimi i Ndikimit Rregullativ, Vendimi Nr. 03/189, datë 23.05.2014, Qeveria e Republikës së Kosovës, qasur më 02.02.2016, shih: <http://bit.ly/1V65Eic>

⁴ Strategjia e Zhvillimit të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM) në Kosovë 2012-2016 me vision 2020, Qëllimi Strategjik 1: Përforsimi i Kornizës Legjislative dhe Rregullative për Krijimin dhe Zhvillimin e NVM-ve, fq. 23, qasur më 03.02.2016, shih: <http://bit.ly/1V65Eic>

⁵ Strategjia Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqëri Civile 2013-2017, Masa/Nën-Objekti 1.1. & 1.2, fq.20, qasur më 02.02.2016, shih: <http://bit.ly/23cES9w>

⁶ Vendimi për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim 2016-2021 (SKZH), Vendimi Nr. 02/71, datë 22.01.2016, Qeveria e Republikës së Kosovës, qasur më 01.02.2016, shih: <http://bit.ly/1W8r0Ls>



ligjore kur vihen në fuqi. Si rrjedhojë, kjo ka rezultuar në sjelljen e pasojave të kundërta prej atyre që janë synuar të arrihen përmes akteve ligjore përkatëse, si dhe krijimin e shpenzimeve të shumta të parasë publike. Në funksion të jetësimit të zbatimit të strategjisë së lartpërmendur, në janar 2016 Qeveria ka miratur Programin për Reforma në Ekonomi⁷. Ky program parasheh ndërmarrjen e veprimeve konkrete nga ana e institucioneve publike qeveritare në aplikimin e VNR-së gjatë hartimit të projekt-akteve ligjore dhe rregullativës joligjore, për të cilat do të bëhet përshkrimi i detajuar në vijim të kësaj analize.

Njëri ndër mbështetësit kyç të zbatimit të VNR në Kosovë në baza të vazhdueshme për përmirësimin e cilësisë së rregullativës në vend është aplikimi i Vlerësimit *ex Post*, për të cilën është përshkruar në Udhërrefyes për Vlerësim *ex post* të Legjislacion në Republikën e Kosovës⁸, të miratuar në korrik 2015. Lidhur me këtë, përmes vlerësimit *ex post*, administrata publike e vendit bënë mbledhjen e të dhënave, si dhe vlerësimin nëse efektiviteti i arritur i arsyeton shpenzimet e krijuara, si dhe identifikimin e arsyeve të mundshme që kanë quar institucionet publike në vështirësi apo dështim të realizimit të qëllimeve të synuara dhe efekteve tjera të dëmshme. Njëherit, në vendimin e qeverisë për zbatimin e vlerësimit *ex-post*, është paraparë që në gjashtëmuajorin e dytë të vitit 2015 të identifikohen dy ligje të cilat do t'i nënshtrohen vlerësimit *ex-post*⁹, e më pas, gjatë vitit 2016 të fillojë zbatimi i këtij vlerësimi.

Me realizimin cilësor të vlerësimit *ex-post* për aktet ligjore në fuqi, Qeveria e Kosovës, orienton vendimmarrjen e duhur për përmirësimin cilësor të rregullatorit, dhe atë duke shfuqizuar aktet në fuqi dhe zëvendësimin e tyre me akte të reja, apo vetëm përmes plotësim-ndryshimit të akteve ekzistuese në fuqi. Po ashtu, edhe Vlerësimi *ex-Post* parasheh që të realizohet përmes metodologjisë dhe zbatimit të VNR¹⁰.

⁷ Vendimi për miratimin e Programit për Reforma në Ekonomi, Vendimi Nr. 04/27, datë 29.01.2016, Qeveria e Republikës së Kosovës, qasur më 02.02.2016, shih: <http://bit.ly/1UScNTQ>

⁸ Udhërrefyes për Vlerësim *ex post* të Legjislacion në Republikën e Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, qasur më 12.01.2016, shih: <http://bit.ly/1SxrDZh>

⁹ Shih 8, fq.2, pika 4 e vendimit të Qeverisë.

¹⁰ Shih 8 fq.18.

2. Vlerësimi i Ndikimit Rregullativ

Vlerësimi i Ndikimit Rregullativ (VNR) është definuar nga Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OBEZH) si *“një qasje sistematike në mënyrë kritike të vlerësimit të efekteve pozitive dhe negative të rregullave të propozuara dhe atyre ekzistuese dhe alternativat jo-rregullatore”*¹¹.

Më në detaje, VNR është mjet thelbësor i politikave për të ndihmuar qeveritë të vlerësojnë ndikimin e akteve ligjore dhe rregullativës joligjore që rregullojnë fushat përkatëse. Njëherit VNR përdoret për të ekzaminuar dhe matur përfitimet, shpenzimet dhe efektet potenciale të akteve ligjore në fuqi apo atyre të reja që do të miratohen.¹² VNR është një mjet i përdorur rregullativ i cili iu ofron politik-bërësve të dhëna cilësore empirike dhe një kornizë krahasimore në të cilën ata mund të vlerësojnë alternativat e mundshme për zgjidhjen e problemeve përkatëse, si dhe pasojat e vendimeve të tyre që mund të kenë në vend.¹³

VNR përdoret si një dokument i analizës nga hartuesit e politikave publike dhe akteve ligjore me qëllim të përkufizimit të saktë të problemit që synohet të rregullohet. VNR ndihmon vendimmarrjen politike me të dhëna konkrete. Në përpilimin e VNR-së merren parasysh kryesisht *ndikimet ekonomike, sociale dhe mjedisore* të politikave publike apo akteve ligjore. Përmes zbatimit të VNR-së gjatë hartimit të rregullativës së re apo plotësim-ndryshimit të asaj ekzistuese në fuqi, politikë-bërësit sigurohen dhe dëshmojnë që veprimet e qeverisë të jenë të arsyeshme, të përshtatshme, efektive dhe përgjithësisht me shpenzime më të ulëta.

Në shumë vende të botës, VNR aplikohet në fazat fillestare të hartimit të projekt-akteve ligjore përkatëse, apo aplikimi i VNR-së në fazën **ex ante** – bazuar në supozimin dhe parashikimin mbi atë

¹¹ Regulatory Policy in Perspective, A Reader's Companion to the OECD Regulatory Policy Outlook 2015, Chapter 2, pg.38, OECD shih: <http://bit.ly/1MPpSKm>

¹² Building an Institutional Framework for Regulatory Impact Analysis (RIA), Guidance for Policy Makers, Chapter I, pg.7, OECD, qasur më 04.02.2016, shih: <http://bit.ly/1PRbmwr>

¹³ Regulatory Impact Analysis in OECD Countries – Challenges for Developing Countries, 2.1, pg. 5, OECD, qasur më 04.02.2016, shih: <http://bit.ly/1V69CY5>

se si gjërat janë shfaqur më parë, në vend sesa të vlerësimit pas realizimit të tyre¹⁴. Ndërsa, një pjesë më e vogël e shteteve në botë aplikojnë VNR-në në fazat pas miratimit të akteve ligjore të cilat janë në fuqi, pra në fazën **ex post** - bazuar në njohuri dhe fakte, duke vlerësuar pas fakteve që janë dëshmuar në vend.¹⁵

Një VNR duhet të përcjellë këta hapa përkatës:

1. Titulli i Propozimit;
2. Identifikimi dhe përkufizimi i problemit;
3. Përshkrimi i qëllimeve të synuara për t'u realizuar;
4. Përshkrimi i opsioneve për zgjidhjen e problemit (përfshirë ato rregullative dhe jo-rregullative, si dhe opsionin e "mosveprimit");
5. Realizimi i konsultimit të hapur dhe publik me palët e interesit (të jashtëm, ekspertë, palët e interesit, grupe tjera);
6. Vlerësimi i shpenzimeve e përfitimeve të mundshme dhe efekteve shpërndarëse të tyre (maksimalisht të vlerësohen në shuma sasiore);
7. Përshkrimi i rekomandimit të opsionit të preferuar bazuar në të dhëna empirike;
8. Përcaktimi i mekanizmave dhe përshkrimi i procesit të monitorimit, vlerësimit dhe raportimit mbi zbatimin e saj¹⁶.

Duke pasur parasysh se shumica e VNR-ve sot zbatohen në fazën fillestare, hapat kryesor të një VNR *ex ante*¹⁷, janë si vijon:


- **Përkufizimi i Problemit:** identifikimi i problemit është i përshkruar në detaje dhe faktorët të cilët kanë ndikuar në krijimin e saj. Problemet e politikës/rregullativës kryesisht janë të klasifikuara në dy grupe të ndryshme: *dështimin e tregut*, përfshirë këtu informalitetin asimetric, pengesat në hyrjen e tregut, fuqitë monopolizuese në treg, shpenzimet e transaksioneve dhe shumë papërsosmëri të tjera në treg të cilat shpijnë në rezultate të pakënaqshme; si dhe *dështimin e rregullativës*, e cila përfshinë të gjitha rastet në të cilat një

¹⁴ Black's Law Dictionary, Eight Edition, Bryan A. Garner – Editor's Chief, *ex-ante* definition, pg. 601, 2004, Thomson West, ISBN 0-314-151990;

¹⁵ Black's Law Dictionary, Eight Edition, Bryan A. Garner – Editor's Chief, *ex-post* definition, pg. 620, 2004, Thomson West, ISBN 0-314-151990;


¹⁶ Building an Institutional Framework for Regulatory Impact Analysis (RIA), Guidance for Policy Makers, Chapter I, pg.14, OECD, qasur më 04.02.2016, shih: <http://bit.ly/1PRbmwr>

¹⁷ Regulatory Impact Analysis in OECD Countries – Challenges for Developing Countries, 2.1, pg. 36-37, OECD, qasur më 04.02.2016, shih: <http://bit.ly/1V69CY5>



sërë rregullash ekzistuese nuk e kanë arritur rezultatin e dëshiruar dhe si e tillë kërkon një përditësim apo shfuqizim të rregullativës përkatëse.

- **Identifikimi i Opsioneve Rregulluese Alternative:** përfshinë përcaktimin e opsioneve rregulluese të mundshme në zgjidhjen e problemeve, si dhe vlerësimin e detajuar të secilit opcion me të dhënat përkatëse. Këto opsione përfshijnë kryesisht rregulloret me ndikim të theksuar, të lehtë, rregullativ përmes informimit, rregullativ bazuar në parime dhe format alternative të ndërhyrjes, siç janë vetë-rregullativa apo bashkë-rregullativa që duhet marrë parasysh, për të siguruar që mjeti i përzgjedhur për zgjidhjen e problemit nuk është jo-proporcional me problemin në shënjestër.
- **Mbledhja e të dhënave dhe administrimi i tyre:** përfshinë fazën vendimtare, e cila mund të përmbajë një llojshmëri të metodave empirike, nga telefonatat dhe intervistat ballë për ballë, e deri tek shpërndarja e pyetësorëve, organizimin e sondazheve dhe konsultimeve elektronike, bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve rregullative (ministritë, autoritetet doganore, agjencitë, institucionet statistikore, etj), fokus grupet, etj. Shuma e të dhënave të nevojshme dhe metodat e praktikuara për administrimin e tyre ndryshojnë varësisht nga natyra e problemit dhe objektives që synohet të arrihet, mirëpo ato nuk duhet të jenë jo-proporcionale me VNR-në: të dhënat dhe informatat në dispozicion janë të destinuara normalisht si funksionale për saktësinë e fazës së vlerësimit që vijon. Kur të dhënat mungojnë, modeli ekonomik është gjithashtu i mundshëm, veçanërisht nëpërmjet modeleve të sjelljes siç janë ato të përdorura në literaturë ligjore dhe ekonomike, si dhe përmes modelimit ekonometrik.
- **Vlerësimi i Opsioneve Alternative:** është një fazë thelbësore e VNR-së, e cila mund të realizohet përmes teknikave të ndryshme – kryesisht përmes Analizës Shpenzimeve-Efektivitetit (ASHE), Analizës Shpenzimeve-Përfitimit (ASHP) dhe Analizës së Rrezikut (ARr). Përherë,



VNR-të në opcionet e shqyrtuara kanë për të përfshirë opcionin “zero” – “mosveprimi” – opsi i pa ndërmarrjen e kurrfarë veprimi dhe mbetjen në gjendjen e njëjtë me problemin e shfaqur, e cila nganjëherë konsiderohet si “bazë” apo skenari “jo ndryshim i politikës”, e cila nuk duhet të ngatërrohet me gjendjen “status quo”, pasi që ajo përfshinë evoluimin e problemit të politikës dhe mungesën e ndërhyrjes së rregullativës së re. Po ashtu, varësisht nga të dhënat e disponueshme dhe thellësia e zbatimit të VNR-së, vlerësimi mund të jetë cilësor dhe sasior, apo edhe kombinimi i të dyjave.

- **Identifikimi i Opcionit të Preferuar të Politikës:** me rastin e posedimit të të dhënave të detajuara për të gjitha opcionet e shqyrtuara, krahasimi shpie lehtë në identifikimin e opcionit më të preferuar. Megjithatë, jo domosdoshmërisht opsi i preferuar duhet të përcaktohet për zbatim, pasi që VNR është vetëm në mbështetje dhe jo në zëvendësim të rolit të politikë-bërësit në përzgjedhjen e opcionit më të përshtatshëm. Kryesisht opsi i preferuar është subjekt i një vlerësimi më në thellësi, përgjithësisht me qëllim të përcaktimit të sasisë së ndikimit të ardhshëm.
- **Dispozitat për Mbikëqyrjen dhe Vlerësimin:** përfshinë përcaktimin e mënyrave në të cilat ndikimi i veprimeve për politikën e përcaktuar mund të monitorohet nëpër kohë, si dhe përcaktimin e mënyrave të rishikimit të qartë dhe efikas të veprimit në të ardhmen. Lidhur me këtë, kurdo që stimujt mund të përzgjedhjen në fazën fillestare (*ex ante*), kjo ndihmon vlerësimin gjatë (*interim*) dhe pas (*ex post*) të veprimit të përcaktuar, e cila duhet të përfshijë veprimin në fazën *ex post*, më pas apo në të ardhmen.

Me rastin e aplikimit të duhur të VNR-së, qeveritë përmirësojnë cilësinë e rregullativës së vendit dhe ngritin *efikasitetin* (arritjen e qëllimeve të synuara me shpenzime sa më të ulëta për të gjitha palët e prekura) dhe *efektshmërinë* (arritjen e qëllimeve të synuara) e politikë-bërjes së tyre të realizuar përmes rregullativës përkatëse në fuqi të zbatuara në vend.

Përfitimet e zbatimit të VNR në hartimin e legjislacionit dhe politikave publike

Aplikimi i VNR-së si mjet për hartimin e politikave publike ligjore dhe joligjore kontribuon në përfitime të shumta. Aktet ligjore përcaktojnë rregullat me të cilat qeveriset jeta e përditshme e bizneseve dhe qytetarëve dhe njëherit janë esenciale për rritjen ekonomike, mirëqenien sociale dhe mbrojtjen e ambientit. Mirëpo, hartimi i tyre përmban kryesisht shpenzime të mëdha financiare dhe ndikime sociale. Me rastin e përdorimit të VNR-së cilësore në hartimin e rregullativës, sigurohet zgjerimi i performancës, shpenzimeve-efikasitetit, si dhe cilësisë së akteve ligjore dhe masave administrative e zbatuese në funksion të jetësimit të tyre në vend.

Konsiderohet se me zbatimin e VNR-së si mekanizëm i vendosjes së rregullativës cilësore ligjore, arrihet që ato të:

- shërbejnë për identifikimin e qartë të qëllimeve të politikave dhe janë efektive në arritjen e atyre qëllimeve;
- janë të qarta, të thjeshta, të kuptueshme dhe praktike për përdoruesit;
- kanë bazë ligjore dhe janë bazuar në të dhëna empirike;
- janë në përputhje me aktet tjera ligjore dhe politikat përkatëse të vendit;
- prodhojnë përfitime të cilat arsyetojnë shpenzimet, duke marrë në konsideratë shpërndarjen e efekteve përreth shoqërisë dhe efekteve ekonomike dhe ato të ambientit;
- janë të zbatuara në mënyrë të drejtë, transparente dhe proporcionale;
- zvogëlojnë shpenzimet dhe shtrembërimin e tregut;
- promovojnë inovacionin përmes stimujve të tregut dhe qasjes së bazuar të qëllimit;
- janë në pajtueshmëri sa më shumë që është e mundur me parimet e konkurrencës, tregtisë dhe ndihmës së investimeve në nivel të brendshëm dhe atë ndërkombëtar.¹⁸

¹⁸ OECD Regulatory Policy Outlook 2015, Chapter 1, Global Trends in regulatory policy: Evidence from new OECD survey data, Box 1.1. What is regulatory quality?, pg. 23, OECD, qasur më 04.02.2016, shih: <http://bit.ly/1RfKvwW>

Përgjithësisht, qeveritë të cilat aplikojnë VNR-në kanë identifikuar katër objektiva kryesore lidhur me shpenzimet dhe ndikimet e rregullativës së vendit, siç janë:

- Përfshirja e qëllimeve të shumta të politikës;
- Përmirësimin e transparencës dhe konsultimit publik;
- Përmirësimi i të kuptuarit të ndikimit në jetën reale të rregullativës së vendosur, përfitimet dhe shpenzimet që rrjedhin nga ato;
- Përmirësimin e llogaridhënies qeveritare ndaj shoqërisë.¹⁹

3. Zbatimi i VNR-së në vendet tjera

Zbatimi i VNR-së së modifikuar ka filluar të bëhet përpara 20 viteve kur edhe OBEZH ka miratuar Rekomandimet e Këshillit të OBEZH në Përmirësimin e Cilësisë së Rregullativës Qeveritare, si një standard i parë ndërkombëtar mbi cilësinë e rregullativës²⁰. Megjithatë, në përgjithësi janë disa sfidat të përbashkëta me të cilat sfidohen shumica e shteteve me rastin e vënies në funksion të VNR-së, siç janë:


- Mungesa e vullnetit politik;
- Kundërshtimet nga politikë-bërësit;
- Mospërfillja nga ana e administratës publike;
- Mungesa e gjithëpërfshirëse e palëve të interesit;
- Mungesa e stafi profesional;
- Niveli i ulët i njohurive për VNR;
- Mungesa e të dhënave të sakta dhe të mjaftueshme.²¹

Ndër vendet e zhvilluara të cilat kanë zbatuar VNR të përshtatshme për rrethanat e vendit, e cila ka sjellë reformat të theksuara të kornizës ligjore, si dhe sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të vendit, njihen Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Mbretëria e Bashkuar, Kanada, Australia, Meksika,

¹⁹ Building an Institutional Framework for Regulatory Impact Analysis (RIA), Guidance for Policy Makers, Chapter I, pg.24-25, OECD, qasur më 04.02.2016, shih: <http://bit.ly/1PRbmwr>

²⁰ Recommendations of the Council on Improving the Quality of Government Regulation, 9 March 1995 - C(95)21/FINAL, OECD, qasur më 08.02.2016, shih: <http://bit.ly/1MPwWGV>

²¹ Building an Institutional Framework for Regulatory Impact Analysis (RIA), Guidance for Policy Makers, Chapter I, pg.25-26, OECD, qasur më 04.02.2016, shih: <http://bit.ly/1PRbmwr>



Irlanda, Danimarka, Suedia, Bashkimi Evropian për rregullativën evropiane, etj.

Mirëpo, trendet janë çdo herë e në rritje edhe për vendet të cilat janë në zhvillim dhe ato më pak të zhvilluara, pasi që VNR përgjithësisht është vlerësuar si një ndër stimujt kryesor rregullativ në përmirësimin, thjeshtësimin, uljen e shpenzimeve, rritjen e efektshmërisë, zgjerimin e grupeve të përfshira në hartimin dhe konsultimet publike për miratimin cilësor të rregullativës ligjore dhe asaj joligjore. VNR ka filluar të zbatohet më herët poashtu edhe në vendet e rajonit, siç janë Kroacia, Serbia, Mali i Zi dhe Maqedoni.

Në aneks të kësaj analize janë paraqitur detaje të aplikimit të VNR në vende të zhvilluara dhe në vendet e rajonit.

4. Përvojat më të suksesshme të aplikimi të VNR-së

Meqë ende nuk ekziston një model ideal i VNR-së i miratuar në nivel ndërkombëtar, lidhur me zbatimin e VNR-së janë zbatuar qasje të ndryshme për të vlerësuar ndikimin e rregullativës varësisht nga çështjet që janë vënë në shënjestër apo fusha përkatëse nga politikë-bërësit. Varësisht nga qëllimet e politikave të vendit dhe kapacitetet e tyre, shtetet kanë inkurajuar prioritetet të ndryshme me rastin e vënies në funksion të VNR-së, për të arritur rezultatet e synuara, siç janë:

- **Holanda** ka miratuar Analizën e Efekteve Biznesore, të koncentruar vetëm në ndikimet që rrjedhin nga bizneset;
- **Çekia** ka miratuar Analizën e Ndikimeve Financiare dhe Ndikimet në Ekonomi, e cila është zgjeruar më pas edhe në ndikimet e tjera socio-ekonomike;
- **Franca** ka miratuar VNR-ne ex-ante për të matur shpenzimet e rregullatorit për bizneset dhe administratë publike;
- **Austria** dhe **Portugalia** kanë vënë në përdorim Analizën Financiare, të fokusuar në shpenzimet direkte buxhetore për administratën e qeveritare;

- **Finlanda** ka një gamë të gjerë të analizave të ndikimeve të pjesshme të cilat mbulojnë buxhetin, ekonominë, organizimin dhe fuqinë punëtore, mjedisin, shoqërinë, shëndetin, politikën regjionale dhe barazinë gjinore. Këto analiza të pjesshme nuk janë të integruara, por realizohen nga ministri të ndryshme, varësisht nga sektori që rregullojnë në saxe të kompetencave të tyre;
- **Belgjika** kryen vetëm vlerësimin e rrezikut në rastet e shëndetit, sigurisë dhe rregullativës së mjedisit;
- **Greqia, Irlanda, Spanja** dhe **Suedia** kanë një listë të ndikimeve që rrjedhin nga rregullaret;
- **Meksika** ka në përdorim tre lloje të vlerësimeve: VNR me ndikim të lartë, VNR e zakonshme, si dhe VNR periodike²².

Megjithatë, prioritet e politikave të cilat janë të përsëritura në shumicën e vendeve janë të fokusuara me vëmendje të shtuar në ngritjen e nivelit të konkurrshmërisë së mallrave dhe shërbimeve në treg, hapjen e tregjeve dhe qarkullimin e lirë të mallrave, inkurajimin e investimeve në mjedis, kushtet e punës dhe punësimin, financave publike, shëndetësisë, ambientit, luftimin e varfërisë, mbështetjen dhe zhvillimin e NVM-ve, si dhe luftimin e ekonomisë joformale.

Se çfarë përmban një VNR ndryshon varësisht nga natyra dhe shtrirja e analizës së bërë. Përgjithësisht, vendet që aplikojnë VNR-në, kanë dalluar procesin preliminar (paraprak) të VNR-së dhe zbatimin e plotë të VNR-së (siç i zbaton Irlanda).

Tabela 2: VNR paraprake dhe VNR e plotë²³

VNR paraprake përfshinë:	VNR e plotë përfshinë:
Përshkrimin e kontekstit të politikës, qëllimeve dhe opsioneve;	Përshkrimi i problemit të politikës;
Identifikimi i shpenzimeve, përfitimeve dhe i ndikimeve të tjera për ndonjë opSION tjetër të cilat janë marrë në konsideratë;	Identifikimi dhe përshkrimi i opsioneve;
Konsultimi publik me palët e interesit;	Analiza e ndikimeve përfshirë shpenzimet dhe përfitimet e secilit

²² Building an Institutional Framework for Regulatory Impact Analysis (RIA), Guidance for Policy Makers, Chapter I, pg.18, OECD, qasur më 04.02.2016, shih: <http://bit.ly/1PRbmwr>

²³ Building an Institutional Framework for Regulatory Impact Analysis (RIA), Guidance for Policy Makers, Chapter I, pg.20-21, OECD, qasur më 04.02.2016, shih: <http://bit.ly/1PRbmwr>

	opsion (përfshirë edhe opsionin e “mosveprimit”);
Rishikimi i mekanizmave dhe stimuljeve specifik për një propozim të suksesshëm të rregullores;	Konsultimi publik formal me palët e interesit;
	Zbatueshmëria në vend dhe përputhshmëria e secilit opsion;
	Rishikimi i procedurave se si do të rishikohet secila politikë, si dhe identifikimi i stimuljeve për matje dhe vlerësim të suksesshëm të secilit opsion;
	Përmbledhja e performancës të secilit opsion dhe identifikimi i rekomandimit të preferuar nga opsion më i përshtatshëm (bazuar në të dhëna).

VNR paraprake përfshinë fazën e identifikimit të rregullativës e cila duhet t’i nënshtrohet VNR-së së detajuar (propozimet e rregullativës), ndërsa VNR e plotë përfshinë vetëm disa propozime, duke u bazuar në kufizimet (pragjet) e përcaktuara nga vetë shtetet. Këto kufizime mund të përcaktohen në vlera monetare të shpenzimeve dhe implikimet e përfitimeve (p.sh. Koreja për propozimet e rregulloreve, shpenzimet e të cilave kalojnë shumën prej 10 miliardë dollarë fitim, 100 milion dollarë në SHBA, ndërsa 50 milion dollarë në Kanada) apo çështjet siç janë shtrirja në ndikimet e konkurrencës, prodhimtarisë, punësimit, hapjen e tregut, inovacionin, investimet, si dhe të numrit të njerëzve të ndikuar nga rregullativa e propozuar²⁴. Irlanda dhe Maqedonia zbatojnë të dy llojet e VNR-së.

5. Kriteret e nevojshme për aplikim cilësor të VNR-së

Me rastin e institucionalizimit të VNR-së, OBEZH rekomandon një listë të plotë me referenca përkatëse për vendimmarrjen e

²⁴ Shih 12, fq. 19.

rregullativës, me ç'rast qeveritë duhet rishikuar VNR-në me syrin kontrollues se:

1. A është definuar saktë problemi?
2. A është i arsyeshëm veprimi i qeverisë?
3. A është rregullativa forma më e mirë e veprimit qeveritar?
4. A ekziston baza ligjore për rregullativën?
5. Cili është niveli (apo nivelet) i përshtatshëm për qeverinë për këtë veprim?
6. A i arsyetojnë përfitimet e rregullativës shpenzimet e shkaktuara?
7. A është transparente shpërndarja e efekteve të rregullativës në shoqëri?
8. A është rregullativa e qartë, konsistente, e kuptueshme dhe e qasshme për përdoruesit?
9. A kanë pasur mundësinë të gjitha palët e interesuara të prezantojnë këndvështrimet e tyre?
10. Si do të arrihet përputhshmëria?²⁵

Gjithashtu, bazuar në mësimet e marra nga eksperiencia ndërkombëtare, OBEZH ka identifikuar praktikat e mira të përdorimit efektiv të VNR-së, duke:

1. Rritur angazhimin politik për VNR;
2. Ndarë me kujdes përgjegjësitë për programimin e elementeve të VNR-së;
3. Trajnuar rregullatorët;
4. Përdorur metoda analitike konsistente dhe fleksibile;
5. Krijuar dhe zbatuar strategji për të mbledhur të dhënat;
6. Integruar VNR-në me procesin e vendimmarrjes, sa më herët që është e mundur;
7. Komunikuar rezultatet;
8. Përfshirja e gjerë e publikut.²⁶

Për të realizuar një VNR të suksesshme, kërkohet ekspertizë edhe në nivelin:

- **Politik** – e cila do të ndihmonte për të ofruar leadership, këshilla dhe rekomandime konkrete për të arritur qëllimet e synuara të politikës dhe adresimin e rezistencave të mundshme për të ndryshuar;

²⁵ The OECD Reference Checklist For Regulatory Decision-Making, qasur më 23.02.2016, shih: <https://www.oecd.org/gov/regulatory-policy/35220214.pdf>

²⁶ Regulatory Impact Analysis: Best Practice in OECD Countries, 1997, fq.7, qasur më 25.02.2016, shih: <http://www.oecd.org/gov/regulatory-policy/35258828.pdf>

- **Ligjor** – për të ofruar këshilla dhe rekomandime në lidhje me zbatimin dhe interpretimin e instrumenteve ligjore, ligjeve të shumëllojshme dhe juridiksionit përkatës;
- **Ekonomik** – VNR vlerëson shpenzimet ekonomike të rregullativës së propozuar dhe përdorimin e të dhënave ekonomike për analiza të bazuara në dëshmi;
- **Komunikim** – e cila është e rëndësishme për të menaxhuar konsultimet e brendshme ndërinstitucionale dhe ato të jashtme me palët e interesit (bizneset, organizatat jo-qeveritare, rregullatorët e pavarur, agjencitë e pavarura, asociacionet e ndryshme).²⁷

Në funksion të mbledhjes së të dhënave cilësore me rastin e zbatimit të VNR-së, shtetet kanë institucionalizuar mekanizma të ndryshëm, siç janë: “*Panelet Testuese të Bizneseve*” në Danimarkë²⁸ për të vlerësuar pengesat e rregullativës që shkaktohen për bizneset, si dhe “*Panelet e Fokusit*” të cilat përdoren për të marrë të dhëna mbi ndikimet e faturave, me ndikim specifik në sektorin e ekonomisë²⁹.

Metodat të cilat përdoren nga shtetet në botë me rastin e përpilimit të VNR-së lidhur me mbledhjen e të dhënave, stimujt që merren parasysh dhe kalkulimin e tyre, janë të ndryshme, si: Analiza e Shpenzimeve/Përfitimeve, Analiza e Shpenzimeve/Efikasitetit apo Analiza e Shpenzimeve/Prodhimit të Jashtëm, Analiza Buxhetore apo Fiskale, Analiza e Ndikimit Shoqëror-Ekonomik, Analiza e Rrezikut, Analiza e Pasojave, Analiza e Përputhjes së Shpenzimeve dhe Testimi i Ndikimit në Biznese³⁰.

6. Zbatimi i VNR-së në Kosovë

Në Kosovë fillimisht është paraparë të përfshihet Vlerësimi i Ndikimit Rregullativ për Rregullim më të Mirë 2014-2020, ku janë përshkruar hapat konkret në sajë të Planit të Veprimit për

²⁷ Shih 12, fq. 35-36.

²⁸ Shih 12, fq. 32.

²⁹ Regulatory Impact Analysis (RIA) Inventory, 2004, OECD, qasur me 29.02.2016, shih: <http://www.oecd.org/gov/regulatory-policy/35258430.pdf>

³⁰ Shih 12, fq. 46.

përfshirjen dhe zbatimin e VNR-së në Kosovë. Në Shtojcën II të kësaj Rregullore³¹, janë përcaktuar treguesit strategjik të rezultateve mbi reformat e legjislacionit ekzistues për të rritur konkurrueshmërinë, si dhe vlerësimin e ndikimit në mjedis:

1. Hartimi i analizave retrospektive vjetore nga secili autoritet rregullator, duke i identifikuar mundësitë e optimizmit;
2. Reduktimi 20% i ngarkesës administrative të përputhshmërisë me kornizën rregullative për fushat e intervenimit, të vlerësuara përmes aplikimit të Modelit Standard të Kostos (MSK), deri më 2020;
3. Hartimi i propozimeve vjetore për reduktim të ngarkesës rregullative nga secili autoritet rregullator për fushat e tyre të rregullores, të llogaritura në bazë të MSK dhe treguesit përkatës (Të Bërit Biznes, Liria Ekonomike, etj.);
4. Vlerësimi vjetor i të paktën pesë sektorëve kyç, duke i identifikuar pengesat kryesore si dhe duke i miratuar amendamentet në kornizën ligjore për t'i zbatuar zgjidhjet e propozuara që dalin nga vlerësimi i ndikimit rregullator;
5. Rritja e qarkullimit në sektorët e përzgjedhur, të paktën dy herë gjatë dy viteve të ardhshme pas implementimit të zgjidhjeve të pengesave të identifikuara si dhe rritja 10% në investime në këta sektorë, krahasuar me trendët historike;
6. Zhvillimi i programeve trajnuese vjetore, duke i mbuluar fushat në vijim: analiza e pengesave rregullative në zinxhirët e vlerave, analiza e treguesve ndërkombëtarë dhe analiza e MKS - së (që nga viti 2014).


Të gjitha këto qëllime të lartëpërmendura nuk janë realizuar (përveç pikës VI, që janë mbajtur 1-2 sesione të trajnimeve), pasi që VNR nuk është vënë fare në funksion dhe të ketë efekt ligjor.

Projektligji për Akte Normative, i cili krijon infrastrukturën ligjore për zbatimin e VNR-së në vend, ende nuk është i miratuar. Sipas Planit Legjislativ për vitin 2016³², miratimi i Projektligjit për Aktet Normative, është paraparë që të miratohet në Qeveri më së largu deri me 29 Prill 2016.

Veprime të cilat janë paraparë të realizohen gjatë vitit 2014 e

³¹ Strategjia për Rregullim më të Mirë 2014-2020, Shtojca II, fq.26-34, Zyra e Kryeministrit, Qeveria e Republikës së Kosovës, qasur më 25.03.2016, shih: <http://bit.ly/1RVMbi3>

³² Programi Legjislativ për vitin 2016, Zyra e Kryeministrit, fq.2, shih: <http://bit.ly/1V3va7V>



2015, barten për vitet vijuese të strategjisë, që në praktikë do të krijojnë një mbingarkesë ligjore e institucionale dhe jo reformim real të administratës publike në jetësimin e VNR-së cilësore. Kjo për faktin se pas miratimit të Projektligjit për Akte Normative, duhet të krijohet Njësia për Rregullim më të Mirë, rekrutimi i stafit, hartimi dhe publikimi i akteve nënligjore të ligjit bazë, miratimi i Manualit për Vlerësimin e Ndikimit Rregullativ, trajnimi i zyrtarëve të administratës publike, e më pastaj të fillohet zbatimi praktik i VNR-së në vend. VNR praktikisht mund të zbatohet vetëm më 2017 dhe atë vetëm për disa projekt-akte.

7. Përfundime dhe rekomandime

Bazuar në përvojat e suksesshme të vendeve të rajonit, si dhe të rregullativës së paraparë për zbatimin e Vlerësimit të Ndikimit Rregullativ për projekt-aktet ligjore, janë një numër i të gjeturave të bazuara në analiza krahasimore dhe rekomandime, për të cilat institucionet publike përgjegjëse inkurajohen që të marrin në konsideratë dhe përfshijnë këto të gjetura gjatë hartimit të Projektligjit për Aktet Normative, përkatësisht pjesën që rregullon fushën e zbatimit të VNR-së, si dhe mekanizmat institucional e administrative në zbatimin efektiv të VNR-së, si dhe për hapat që do të ndërmarrin në arritjen e qëllimeve të përcaktuara në Programin për Reforma në Ekonomi, si vijon:

- I. Të definohet qartë se sa akte ligjore do t'i nënshtrohen procesit të Vlerësimit të Ndikimit Rregullativ, kjo pasi që sipas Strategjisë Kombëtare për Zhvillim, është paraparë që VNR do të zbatohet mesatarisht për 20 ligje të reja të miratuara në Kuvend për çdo vit; ndërsa, në Programin për Reforma në Ekonomi (PRE) është përcaktuar pilotimi dhe zbatimi i VNR për tri projekt-akte në vitin 2017, si dhe pesë projekt-akte në vitin 2018.
- II. Të sinkronizohet dhe krijohet një pasqyrim i qartë i veprimeve që do të ndërmerren nga vlerësimi ex-post dhe VNR, në mënyrë që të organizohet në mënyre efikase dhe efektive reforma e rregullatorit në vend. Kjo, duke u ndarë qartë dhe konsultuar bashkërisht agjendat e të dy proceseve për përzgjedhjen e akteve ligjore apo projekt-akteve që do t'i nënshtrohen këtyre dy mënyrave të vlerësimit (ex-post dhe ndikimit rregullativ). Me ndërlidhjen dhe koordinimin e veprimeve të të dy proceseve, evitohen veprimet e dyfishta për çështjet e njëjta dhe sigurojnë cilësi të përgjithshme të sistemit rregullativ të aplikuar në Kosovë. Kjo do të ndihmojë në shkurtimin e periudhave të zgjatura të hartimit ligjor, lehtësimin e administratës publike dhe rritjen e efikasitetit në procesin e hartimit ligjor, anashkalimin e duplikimit të shërbimeve që rregullojnë


çështjet e njëjta, si dhe uljen e shpenzimeve dhe largimin e procedurave të mbingarkuara administrative.

III. Projektligji për Aktet Normative i cili do të përfshijë vënien në fuqi dhe përdorim të VNR, të përfshijë dhe precizojë qartë :

- a) Rishikimin dhe thjeshtësimin sa më shumë që mund të bëhet me rastin e hartimit ligjor qeveritar. Në vend të Memorandumeve Shpjeguese dhe Koncept Dokumenteve të cilat zbatohen aktualisht në procesin e hartimit ligjor, të largohet tërësisht Memorandumi Shpjegues e Vlerësimi i Ndikimit Financiar, ndërsa Koncept Dokumenti të zëvendësohen me Deklaratën apo Raportin e Vlerësimit të Ndikimit Rregullativ, e cila do të përfshijë domosdoshmërisht Vlerësimin e Ndikimit Financiar në sajë të VNR-së.
- b) Përkufizimin e saktë të përfshirjes së projekt-akteve ligjore apo edhe të projekt-akteve nënligjore (lidhur me këtë, rekomandohet që të zbatohet për të dy kategoritë ligjore meqë rregullojnë një gamë të përbashkët të fushave përkatëse). Mirëpo duke pasur parasysh kapacitetet e ulëta financiare e profesionale të vendit, kjo mund të zbatohet në mënyrë të ndarë :
 - i. të zbatohet VNR vetëm për projekt-aktet ligjore, deri në vitin 2019; më pas
 - ii. të zbatohet VNR për të gjitha projekt-aktet ligjore dhe nënligjore nga viti 2020;
- c) Të bëhet përshkrimi i qartë i mënyrës së përzgjedhjes së projekt-akteve normative të cilat do t'i nënshtrohen VNR-së. Lidhur me këtë duhet të përcaktohen kriteret mbi përzgjedhjen e draftimit të projekt-akteve që do të realizohen përmes zbatimit të VNR-së, të cilat përfshijnë:
 - i. **Kriteret ligjore** që përfshijnë gamën e të gjitha obligimeve ligjore të cilat do të realizohen në funksion të zbatimit të obligimeve ndërkombëtare që ka marrë Kosova në zbatimin e tyre brenda periudhës së caktuar, siç është respektimi në baza të vazhdueshme të parimeve bazë të legjislacionit të Bashkimit Evropian, si dhe përafrimin e rregullativës së vendit me obligimet ligjore të

përcaktuara në Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit të Kosovës.

- ii. **Kriterin ekonomik** mbi ndikimet e mundshme që do të rrjedhin nga hyrja në fuqi e atyre projekt-akteve, në vlerë monetare, për shembull projekt-aktet ligjore që do të kenë ndikim në vend në vlerë prej dhjetë milion euro , apo projekt-aktet ligjore që do të kenë ndikim në vend me shpenzime prej një milion euro për zbatimin e tyre;
 - iii. **Kriteret administrative** dhe teknike të cilat duhet patjetër të zbatohen në funksion të përmirësimit të cilësisë dhe realizimit të reformës së rregullativës së vendit, me fokus në ato me ndikim në sektorin e të bërit biznes, mbështetjen e ndërmarrësisë, zhvillimin e NVM-ve, kështu duke siguruar reformë rregullative dhe njëkohësisht zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të vendit, siç janë sigurimi dhe respektimi i parimeve të tregut të drejtë, rritjen e konkurreshmërisë, sigurimin e cilësisë së mallrave dhe shërbimeve, ngritjen e nivelit të investimeve, etj.
- d) Të hartohet **Plani Vjetor për Vlerësimin e Ndikimit Rregullativ** dhe i njëjti të jetë i përditësuar çdo vit, ku do të përcaktohen projekt-aktet ligjore të cilat do t'i nënshtrohen VNR-së, e cila duhet të jetë në harmoni me planifikimet e përcaktuara në Programin Legjislativ vjetor qeveritar. Vënia e këtij plani si obligim ligjor, do të zvogëlon mundësinë e shpërfilljes së mos-zbatimit të VNR-së në institucionet publike me rastin e hartimit të politikave të tyre ligjore e jo-ligjore.
- f) Të bëhet përcaktimi i **institucionit përgjegjës** i cili do të jetë mbikëqyrës i respektimit të procesit të VNR-së, vlerësimin e cilësisë së VNR-së së zbatuar për projekt-aktet ligjore dhe rregullativën jo-ligjore, komentimin, rishikimin, si dhe plotësim-ndryshimin e saj (VNR-së së përpiluar), i përcaktuar në Projektligjin e Akteve Normative.
- g) Të përcaktohet se çfarë ndikime do të përfshijë Vlerësimi i Ndikimit Rregullativ. Lidhur me këtë




rekomandohet të përfshihet Vlerësimi i Ndikimit Ekonomik, Shoqëror dhe Mjedisor. Mirëpo, të lihet mundësia që varësisht nga natyra e rregullativës ligjore apo joligjore dhe qëllimit që synohet të arrihet në fushën përkatëse, të përfshihen edhe vlerësime tjera, siç janë ato mbi shëndetin, konkurrencën, punësimin, etj.

- h) Të përcaktohen tre llojet kryesore të analizave të cilat duhet përdoren në zbatimin e VNR-së (kryesisht rekomandohen të zbatohen Analiza e Shpenzimeve-Përfitimeve, Analiza e Shpenzimeve-Efektivitetit dhe Analiza Shumë-Kriterëshe), mirëpo të mos kufizohet vetëm në ato. Kjo pasi se si pasojë e mungesës së të dhënave të kënaqshme në nivel të përgjithshëm vendi, do të paraqitet nevoja e aplikimit të llojeve të tjera të analizave për hartimin e VNR-së cilësore (siç janë: Analiza e Rrezikut, Analiza Buxhetore-Fiskale, Analiza e Pasojave, etj).

- IV.** Hartimi i Manualit mbi metodat dhe teknikat e zbatimit të VNR në Kosovë, të përfshijë një konsultim të gjerë dhe kohë të mjaftueshme për të prezantuar perspektivat e tyre të gjitha palët e interesit, si dhe me përqendrim të shtuar në përfshirjen e bizneseve, agjencive, instituteve, organizatave të shoqërisë civile, si dhe institucione tjera që merren me hartimin dhe zbatimin e politikave me ndikim të lartë në shoqëri, e të cilat mund të përfitojnë me zbatimin cilësor të VNR-së gjatë punës së tyre;

- V.** Përfshirja e zyrtarëve qeveritar profesional për fushat përkatëse, përfaqësuesve të autoriteteve rregullatorë, përfaqësues të organizatave jo-qeveritare dhe bizneset në trajnimet profesionale mbi hartimin e VNR-së cilësore, teknikat e metodat e përdorura, organizimi dhe kalkulimi i të dhënave, përzgjedhja e opsioneve të duhura dhe vendosja e mekanizmave matës për mbikëqyrjen e efekteve të rregullativës së vënë në vend apo fusha përkatëse, të rregullohet në baza të vazhdueshme dhe të përhershme nga ana e institucioneve publike.

- 
- VI.** Me rastin e krijimit të databazës elektronike të të dhënave të cilat do të përdorën në përpilimin e VNR-së dhe përmbajtjes së VNR-së për projekt-aktet ligjore apo rregullativën joligjore, institucionet përgjegjëse të krijimit dhe mirëmbajtjes së saj, të sigurohen se do të përfshihen:
- i. të gjitha të dhënat të cilat do të ruhen, të cilat janë të kërkueshme edhe nga institucionet ndërkombëtare të cilat merren me vlerësimin e ndikimit rregullativ të rregullativës së vendeve në botë (p.sh. OBEZH);
 - ii. ato të dhëna të cilat në baza të vazhdueshme janë të dhëna statistikore e të cilat janë obligime ligjore për komunikim të atyre të dhënave (p.sh. EUROSTAT), si dhe ato që kërkohen nga obligimet ndërkombëtare që të ndërmarrë shteti (p.sh. MSA);
 - iii. të dhënat e mbledhura të jenë cilësore dhe reale dhe sipas kërkesave që aplikohen me standardet e VNR-së, pasi që ato do të shërbejnë edhe për qëllime të tjera si njësi matëse për politikat publike tjera që ndërlidhen me ato për të cilat është zbatuar VNR.

Aneks 1: Zbatimi i VNR në vendet e zhvilluara, BE dhe vendet e rajonit

VENDI:	Zbatimi i VNR:	Moszbatimi i VNR:	Kriteri Financiar për zbatimin e VNR:	Institucioni Mbikëqyrës i VNR:	Dokumenti i VNR:
SHBA	Legjislacionin dytësor të Agjencive Federale;	- Legjislacionin e Agjencive të Pavarura (p.sh. Komisioni Federal i Tregtisë, Komisioni i Letrave me Vlerë dhe Këmbimeve, etj). - Legjislacionin i cili shqyrtohet në Kongres (p.sh. Akti i Përballueshëm i Kujdesit Shëndetësor "Obamacare").	Rregullativën "madhore" federale, të cilat përmbushin disa kriterë cilësorë dhe sasiorë, përfshirë këtu pritjet e ndikimit të tyre në vlerë prej të paktën \$ 100 milion USD;	<i>Zyra për Informim dhe Çështje të Rregullatorit</i> -Organizim: nivel qendrorë; -Lëshon Opinionin përkatës, por jo obligativ të respektohet;	<i>"Njoftim Mbi Vendim-Marrjen e Propozuar"</i>
Kanada	Rregullativën federale;		Rregullativën kryesore të vendit, përfshirë këtu pritjet e ndikimit të tyre në vlerë prej të paktën \$ 50 milion ;	<i>Spektori i Çështjeve të Rregullativës / Sekretariati i Bordit të Thesarit Kanadez;</i> Pastaj, Qendra e Ekspetizës së Rregullatorit/ Sekretariati i Bordit të Thesarit Kanadez;	<i>Deklarata e Analizës së Ndikimit Rregullativ;</i>
Australia	Rregullativën në tërësi;	Në rastet e mungesës apo rrethanave të jashtëzakonshme, një projekt-rregullator me ndikime të mundshme në biznes apo në sektorin jo-fitimprurës, e të cilat nuk janë të vogla, nuk mund të dërgohet në Kabinetin apo vendimarrësit tjerë nëse hartimi i rregullativës përkatëse nuk ka vepruar në		<i>Zyra e Praktikës më të mirë rregullative / Departmenti i Kryeministrit dhe Kabinetit;</i>	<i>Deklarata e Ndikimit Rregullativ</i>

		përputhje me kërkesat e Kornizës së VNR-së.			
Meksika	Rregullativën në tërësi;			<i>Komisioni Kombëtar i Përmirësimit të Rregullatorit;</i> -Organizim: nivel qendrore; -Lëshon Opinionin përkatës, por jo obligativ të respektohet;	<i>Analiza e Ndikimit Rregullativ;</i>
Suedia	Rregullativën në tërësi (të reja dhe plotësim-ndryshimet);			<i>Këshilli për Rregullim më të Mirë – Agjencia Suedeze për Rritje Ekonomike dhe Regjional;</i> -Organizim: nivel qendrore por agjenci e pavarur; -Lëshon Opinionin përkatës, por jo obligativ të respektohet;	<i>Analiza e Ndikimit të Rregullores;</i>
Zelanda e Re	Rregullativën në tërësi;			<i>Komisioni i Produktivitetit të Zelandës së Re/sektori i kabinetit qeveritar të VNR-së</i> -Organizim: nivel qendrore or agjenci e pavarur; -Lëshon Opinionin përkatës, por jo obligativ të respektohet;	<i>Deklarata e Ndikimit Rregullativ</i>
Bashkimi Evropian	Të gjitha aktet ligjore, jo-ligjore, aktet e zbatimit dhe delegimit, të cilat pritet të kenë ndikim ekonomik, social e mjedisor;			<i>Bordi i Shqyrtimit Rregullativ - Komisioni Evropian;</i> <i>Drejtoria për Vlerësimin e Ndikimit Rregullativ – Parlamenti Evropian;</i>	<i>Raporti i Vlerësimit të Ndikimit;</i>
Kroacia ³³	Të gjitha projekt-			<i>Zyra Ligjore e Qeverisë së Republikës</i>	<i>Deklarata e Vlerësimit</i>

³³ Act on Regulatory Impact Assessment, The Croatian Parliament, 15 Korrik 2011, qasur më 15.02.2016, shih: <http://bit.ly/1qJB29R>

	aktet ligjore të përshkruara në Planin Vjetor të Akteve Normative;			së Kroacisë; - Organizim: nivel qendrore - Lëshon Opinionin përkatës, që janë obligative të miratohen;	të Ndikimit Rregullativ;
Serbia³⁴	Të gjitha projekt-aktet ligjore të përshkruara në Planin Vjetor të Akteve Normative;		Akte nënligjore;	Zyra Qeveritare për Reforma të Rregullativës dhe Vlerësimin e Ndikimit Rregullativ; -Organizim: nivel qendrore - Lëshon Opinionin përkatës, që janë obligative të miratohen;	Deklarata e Vlerësimit të Ndikimit Rregullativ;
Maqedonia³⁵	Të gjitha projekt-aktet ligjore të përshkruara në Planin Vjetor të Akteve Normative;		Akte nënligjore;	Zyra për Reforma të Rregullativës dhe Vlerësimin e Ndikimit Rregullativ; -Organizim: nivel qendrore; - Lëshon Opinionin përkatës, që janë obligative të miratohen;	Deklarata e Vlerësimit të Ndikimit Rregullativ;
Mali i Zi³⁶	Të gjithë rregullativën e re dhe plotësim ndryshimin e akteve në fuqi, por vetëm ato me ndikimi ekonomik;			Këshilli për Reforma Rregullative dhe Përmirësimin e Mjedisit Biznesor;	Vlerësimi i Ndikimit Rregullativ;

³⁴ Regulation on the Office for Regulatory Reform and Regulatory Impact Assessment (RIA), qasur më 16/02/2016, shih: <http://bit.ly/1XxkBI0>, si dhe dhe "Towards Better Regulation – Regulatory Impact Assessment in Montenegro", Institute Alternativa, qasur më 20.02.2016, shih: <http://bit.ly/1SCDDIV>

³⁵ Regulations Governing Regulatory Impact Assessment, Republic of Macedonia, Ministry of Information Society and Administration, Shtator 2013, qasur më 21.02.2016, shih: <http://bit.ly/1qJAZe4>
"Towards Better Regulation – Regulatory Impact Assessment in Montenegro", Institute Alternativa, qasur më 20.02.2016, shih: <http://bit.ly/1SCDDIV>

³⁶ Montenegro Assessment Report 2013, SIGMA Country Assessment Reports, OECD (2013), qasur më 17.02.2016, shih: <http://bit.ly/1Q9oXiS>

Instituti GAP është Think-Tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

Ky projekt është mbështetur nga:



Instituti GAP mbështetet nga:

